



EITI Shqipëri Plani i Punës 2020

Ver.1.1
Janar 2020

Shënim

Ky dokument paraqet Planin e Punës të EITI-it Shqiptar për vitin 2020.

Në këtë dokument EITI Shqipëri dhe MSG kanë përcaktuar objektivat dhe detyrat për tu përmbushur gjatë vitit 2020.

Rrjedha e natyrshme e procesit EITI na kërkon që të ngjitemi nga faza “Fillestare- Informuese” në fazën e “E Avacuar- të Performimit” EITI-t. Prandaj ne do të fokusohemi dhe do të investojmë në ato aktivitete të cilat do ti mundësojnë proceseve EITI të jenë ritmike dhe të qëndrueshme.

Për referencë lexuesit:

Standarti EITI: <https://eiti.org/document/eiti-standard-2019>

Kërkesa 1.5 Plani i Punës: <https://eiti.org/document/standard#r1-5>

Programi kombëtar dhe prioritetet qeverisëse janë të listuara: <https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

Përfituesit Realë: <https://eiti.org/beneficial-ownership>

Tregëtimi i lëndëve të para: <https://eiti.org/commodity-trading>

Validimi: <https://eiti.org/document/albania-validation-2019>

Në vijim, janë ato prioritetet kombëtare që do të jenë në formë objektivash në Planin tonë të Punës, në përpjekje për të maksimizuar procesin EITI në vend, dhe ndikojnë në rrugëtimin shqiptar drejt "Rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse", i cili është objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare!¹

¹ <https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

1. Lufta kundër Korrupsionit.
2. Mirëqeverisja e Burimeve Natyrore.
3. Të Dhëna të Hapura.
4. Përgatitja e një pakete ligjore për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse dhe publikimin e Përfituesve Realë të kompanive që operojnë në sektorët e Industrisë Nxjerrëse dhe Elektro Energjisë.²
5. Transparenca në procedurat e tregëtimit të lëndëve të para nga shoqëritë me kapital Publik.³
6. Identifikimi i ndikimit të industrive nxjerrëse, kontributi në rritjen ekonomike, të punësimit si dhe aspektin social në Shqipëri.
7. Ndikimi i industrive nxjerrëse në Mjedis.
8. Adresimi dhe puna për kryerjen brënda afateve të Veprimeve Korrigjuese të dala nga procesi i Validimit dhe Vendimi i Bordit EITI për Shqipërinë.⁴
9. Mbështetje për Shoqërinë Civile.

Më poshtë, ju do të gjeni një arsyetim të shkurtër në lidhje me objektivat në axhendën EITI dhe prioritetet tona kombëtare.

1. Lufta kundër Korrupsionit

Qasja e qeverisë shqiptare në luftën kundër korrupsionit përqendrohet në tre drejtime: parandalim, ndërgjegjësim dhe ndëshkim.

Si do të ndikojnë aktivitetet tona EITI në këtë axhendë kombëtare?

Ne planifikojmë ta bëjmë atë nëpërmjet "Reformimit të kornizës ligjore kombëtare për menaxhim më të mirë të burimeve natyrore". Bazuar në gjetjet dhe pikat nevralgjike që i kemi identifikuar gjatë përgatitjes së raporteve tona EITI ne kemi nevojë për të punuar me kornizën tonë ligjore për të mundësuar një rrjedhë normale të procesit të raportimit. Gjatë vitit 2020 EITI Shqipëri do të punojë për miratimin dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore dhe rregullative të sugjeruara nga "rishikimi ligjor" dhe të rëna dakord me palët e interesit. Zbatimi i ndryshimeve ligjore që

² <https://eiti.org/beneficial-ownership>

³ <https://eiti.org/commodity-trading>

⁴ <https://eiti.org/document/albania-validation-2019>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

do të mundësojnë dhe rregullojnë lirim, botimin dhe të dhënat e hapura për çdo agjenci qeveritare që merret me qeverisjen e burimeve natyrore.

Cili është objektivi ynë EITI në lidhje me pjesën e ndërgjegjësimit në axhendën Antikorrupsion?

1.2 Fuqizimin e MSG përmes pjesëmarrjes më të gjerë të grupeve të interesit dhe ndërtimit të kapaciteteve;

1.3 **Rritja e pjesëmarrjes së publikut dhe angazhimin e palëve të interesit në menaxhimin e burimeve natyrore.** Aktivitete për Rritjen e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimi me një fokus të veçantë në komunikim të përshtatur për aktorët tanë që do të synojnë të krijojnë një platformë për debat profesional; ne kemi identifikuar disa partnerë në proceset tona EITI tilla si studentë, akademikë, ligjvënës, analistë, deputetë, etj. Ata duhet të jenë pjesë e proceseve EITI dhe çdo komunikim duhet të përshtatet sipas specifikave të tyre.

2. Mirëqeverisja e Burimeve Natyrore

2.1 Hidrokarburet- Në këtë sektor do të synohet raportimi i Përfituesve Realë nga ana e kompanive të naftës dhe raportimi nga ana e Albpetrol i Tregëtimit të produkteve të lëndëve të para.

2.2. Industria Minerare- Në këtë sektor do të synohet gjithëpërfshirja dhe raportimi EITI në kohë dhe me cilësi.

2.3. Në sektorin elektroenergjetik – Do të synohet gjithëpërfshirja e këtij sektori në raportimet EITI dhe rregullimin ligjor të procesit të raportimit në këtë sektor.

Qeveria Shqiptare po synon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit Elektroenergjetik dhe të Industrive nxjerrëse, duke e shndërruar atë në një sektor të qëndrueshëm financiarisht, operacionalisht dhe teknikisht. Ajo ka renditur mirëqeverisjen e burimeve natyrore, si pjesë e prioritetëve të saj strategjike në kapitullin Rritje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse⁵.

Në kuadër të Programit të Qeverisë por edhe të prioritetëve tona në vitin 2020, përveç fokusit në sektorët e Naftës e të Minerave e cila është duke u mbuluar tërësisht me anë të iniciativës EITI dhe raporteve EITI, ka fokus të veçantë prodhimi i Elektroenergjisë që është futur si risi për herë të parë nga Shqipëria në raportimin EITI.

⁵ <https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

Cili është Objektivi EITI në lidhje me Axhendën Kombëtare për Mirëqeverisjen Burimeve Natyrore?

Qendra e aktiviteteve EITI në përputhje dhe me standardet EITI do të jetë Prodhimi dhe publikimi i raporteve EITI në formatin vit + 1. Përmirësimi i çdo raporti konsektiv EITI do të jetë objektivi kryesor.

Me përfshirjen e suksesshme në raportet EITI 2013 + 2014 të sektorit të Hidroenergjisë, raportet EITI në vitet e ardhshme do të vazhdojnë të përmbajnë një raportim të plotë për përdorimin e burimeve ujore.

Aspekte të rëndësishme që plotësojnë qeverisjen e burimeve natyrore do të jenë në axhendën tonë, të tilla si çështjet Lokale dhe Mjedisi.

3. Të Dhëna të Hapura

Kryeministri Rama ka vënë theksin në një qeverisje të hapur dhe transparente, si një nga prioritetet kryesore të axhendës kombëtare për "krijimin e një shoqërie të drejtë".

Më 18.2.2015, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 147: "Për miratimin e dokumentit të politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura"⁶.

Bazuar në këto prioritete dhe me rritjen e kërkesave nga publiku për një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme, Shqipëria po kalon transformime shumë të rëndësishme dhe masive në lidhje me axhendën e saj digjitale në E-qeverisje dhe Strategjinë e Shoqërisë së Informacionit si pjesë e angazhimeve OGP të saj në "Të Dhënat e Hapura"⁷.

Cili është Objektivi ynë EITI përsa i përket të Dhënave të Hapura në prioritetet e axhendës kombëtare?

⁶ http://mobile.ikub.al/LIGJE_CATEGORY/PeR-MIRATIMIN-E-DOKUMENTIT-TePOLITIKAVE-PeR-IMPLEMENTIMIN-E-Te-DHEHAVE-Te-HAPURA-PUBLIKE-DHE-KRIJIMIN-E-PORTALIT-Te-Te-DHEHAVE-Te-HAPURA--1508030128.aspx

⁷ http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf.

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

3.1 Në kuadër edhe të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare, përfshirja e të Dhënave të hapura për EITI-n dhe qeverisjen e Burimeve Natyrore, në prioritetet kombëtare për sistemet e hapura të të dhënave të qeverisë dhe të punuarit drejt integritit, krijimin e të dhënave të hapura për EITI-n në sistemet qeveritare për të siguruar afate kohore, cilësi të të dhënave, ripërdorim dhe efektivitet në kosto.

4. Përgatitja e një pakete ligjore për publikimin e Përfituesve Realë të kompanive që operojnë në sektorët e Industrisë Nxjerrëse dhe Elektro Energjisë.

Identiteti i pronarëve të vërtetë - "Pronarët përfitues" - të kompanive që kanë fituar të drejtën për nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve shpesh është i panjohur, i fshehur nga një zinxhir i subjekteve të papërgjegjshme të korporatave. Ky problem gjithashtu prek sektorët e tjerë dhe shpesh ndihmon për të ushqyer korrupsionin dhe evazionin fiskal dhe ndikon negativisht komunitetet që jetojnë në Zonat ku ushtrohet aktiviteti i Industrisë Nxjerrëse.

Deri në vitin 2020, të gjitha vendet e EITI-t duhet të sigurojnë që kompanitë që aplikojnë ose kanë interesa pjesëmarrëse në një licencë ose kontratë naftë, gazi ose minierash në vendin e tyre, të zbulojnë pronarët e tyre përfitues.

Standardi EITI gjithashtu kërkon që zyrtarët publikë - të njohur edhe si persona të ekspozuar politikisht (PEPs) të jenë transparente në lidhje me pronësinë e tyre në kompanitë e naftës, gazit dhe minierave.

Ky informacion do të jetë publikisht i disponueshëm dhe do të publikohet në Raportet EITI dhe / ose në regjistrat publikë.⁸

Cili është Objektiv i EITI përsa i përket Përfituesve Realë në prioritetet e axhendës kombëtare?

Krijimi i një baze ligjore për sa i përket Përfituesve Realë, me anë të miratimit të Ligjit EITI apo rregullimeve të tjera të mundëshme ligjore. Ndërkohë ka filluar aplikimi i raportimit në mënyrë vullnetar në raportimin vjetor EITI.

Ky është një kapitull krejtësisht të ri për dhënien e informacioneve mbi Përfituesit Realë (Beneficial Ownership) që do të kërkojë aktivitete të dedikuara dhe burime për përgatitjen e pranimit publik, konsultime të gjera me grupet e interesit, ndryshime dhe zbatime ligjore.

⁸ <https://eiti.org/beneficial-ownership>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

5. Transparenca në procedurat e tregëtimit të lëndëve të para nga Shoqëritë me kapital publik

Një nga objektivat kryesore të EIT-it është të hedh dritë mbi të ardhurat që një vend merr në këmbim të naftës, gazit dhe mineraleve të tij.

Në shumë vende të pasura me burime, pagesat nga kompanitë në qeveri për të drejtat e ekstraktimit të burimeve bëhen në natyrë, nëpërmjet transferimeve fizik të naftës, gazit dhe mineraleve, në vend të transferimit të parave. Gjithashtu, të ardhurat fizike mund të merren sepse shteti ose ndërmarrja shtetërore (NSH) zotëron aksione në një licencë prodhimi.

Shpesh Shteti apo NSH i shet këto burime fizike, tek kompanitë tregtare ose rafineritë vendase. Në mënyrë që qeveritë që zbatojnë EITI-n të llogarisin plotësisht të gjitha të ardhurat e marra nga burimet natyrore, është e nevojshme të dihet se sa të ardhura merr Shteti ose NSH nga shitja e këtyre burimeve, si dhe nëse këto të ardhura të shitjes transferohen në buxhet.⁹

Cili është Objektivi EITI përsa i përket Transparencë në procedurat e tregëtimit të lëndëve të para në prioritetet e Axfordës Kombëtare?

5.1 EITI Shqipëri në vitin 2018 ishte pjesë e një Projekti Pilot të iniciuar nga EITI International (Commodity Trading), nga i cili u prodhua një Raport që skanonte deri diku situatën aktuale në lidhje me këtë çështje në vendin tonë. Objektivi ynë është pasqyrimi i plotë i procedurave dhe të ardhurave që përftohen nga tregëtimi i lëndëve të para në vendin tonë, në raportet EITI.

6. Identifikimi i ndikimit të industrive nxjerrëse, kontributi në Rritjen ekonomike, të Punësimit si dhe aspektin Social në Shqipëri.

Në programin e saj Qeveria do të mbështesë edhe më tej zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në industrinë minerare dhe jo vetëm, duke synuar rritjen e eksporteve të produkteve të përpunuara metalore e jometalore.

Përveç rritjes së punësimit dhe mirëqenies për banorët e zonave mineralmbajtëse, ky zhvillim do t'i japë një hov ekonomisë kombëtare në tërësi dhe përmirësojë bilancin tregtar të vendit.¹⁰

Cili është Objektivi EITI përsa i përket Identifikimit të ndikimit të industrive nxjerrëse, kontributi në rritjen ekonomike, të punësimit si dhe aspektin social në Shqipëri në prioritetet e axhendës kombëtare?

⁹ <https://eiti.org/commodity-trading>

¹⁰ <https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

6.1 Duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë, por edhe ndjeshmërinë që ka kjo çështje në planin kombëtar dhe ndërkombëtar, synohet të kryhet një studim mbi ndikimin e industrive nxjerrëse kontributin në rritjen ekonomike, të punësimit si dhe aspektin social në Shqipëri. Duke u bazuar në gjetjet e këtij studimi do të përcaktohen dhe hapat e mëvonshëm për tu ndërmarrë.

7. Ndikimi i industrive nxjerrëse në Mjedis.

Në programin e saj Qeveria do të mbështesë edhe më tej zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në industrinë minerare dhe jo vetëm. Do të vazhdojë monitorimi i rreptë i zbatimit të rregullave teknike në miniera dhe zhvillim të industrisë në harmoni me mjedisin.¹¹

Cili është Objektiv i EITI përsa i përket identifikimit të ndikimit në mjedis të industrive nxjerrëse në Shqipëri në prioritetet e axhendës kombëtare?

7.1 Duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë, por edhe ndjeshmërinë që ka kjo çështje si në planin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar, synohet kryerja e një studimi mbi ndikimin e industrive nxjerrëse në mjedis në Shqipëri. Duke u bazuar në gjetjet e këtij studimi do të përcaktohen dhe hapat e mëvonshëm për tu ndërmarrë.

8. Adresimi dhe puna për kryerjen brenda afateve të Veprimeve Korrigjuese, të dala nga procesi i Validimit dhe Vendimi i Bordit EITI për Shqipërinë

Mbas procesit të Validimit të dytë që u krye në mars 2019, Bordi EITI vendosi më 17 Qershor 2019 që Shqipëria ka bërë **Progres Domethënës** në përgjithësi në zbatimin e Standardit EITI 2016, me përmirësime të konsiderueshme në disa kërkesa individuale.

Bordi njohu përpjekjet e Shqipërisë për të përdorur EITI si një mjet diagnostik të administrimit të qeverisë së financave publike të të ardhurave nxjerrëse. Raportimi publik i transferimeve lidhur me rentën minerare ka krijuar një interes të konsiderueshëm publik. Bordi inkurajon Shqipërinë të forcojë më tej zbulimet publike, veçanërisht të lidhura me shpërndarjen e licencave dhe pjesëmarrjen e shtetit në naftë dhe gaz.

¹¹ <https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

Gjithashtu inkurajon gjithëpërfshirjen dhe besueshmërinë e këtyre informacioneve shpjeguese, duke përfshirë nivelin vendor. Bordi mirëpret shqyrtimin e mundësive të Shqipërisë për të shpalosur në mënyrë sistematike të dhënat e kërkuara në Standartin EITI.

Bordi ka përcaktuar që Shqipëria do të ketë 12 muaj, deri më **17 Qershor 2020** deri në Validimin e tretë për të zbatuar veprimet korrigjuese që janë lënë si detyrë për tu kryer.¹²

Cili është Objektivi ynë EITI përsa i përket Adresimit dhe punës për kryerjen brënda afateve të Veprimeve Korrigjuese të dala nga procesi i Validimit dhe Vendimi i Bordit EITI për Shqipërinë në prioritetet e axhendës kombëtare?

8.1 Adresimi i menjëhershëm, shpërndarja dhe ndjekja sipas subjektit përkatës të veprimeve korrigjuese dhe përmbushja e tyre brenda afatit të përcaktuar në mënyrë që në validimin e tretë që do të kryhet në vitin 2020 të kemi arritur përmirësimin e gjithë komponentëve që shërbjnë si subjekt vlerësimi në proces.

9. Mbështetje për Shoqërinë Civile

Në kapitullin Programor për Shtetin e së Drejtës dhe Demokratizimin e Shoqërisë, Qeveria shqiptare e konsideron prioritetet të saj mbështetjen e Shoqërisë Civile. Qeveria Shqiptare është e bindur se me fuqizimin e shoqërisë civile do të kemi një mjet të rëndësishëm që do të plotësojë hendekun midis qytetarëve dhe institucioneve. Objektivi i saj është të promovojë krijimin e një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon shoqërinë civile pavarësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.

Cili është objektivi ynë EITI në lidhje me Axhendën e Shoqërisë Civile?

9.1 Nxitja e krijimit të një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon pavarësinë e shoqërisë civile, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë në procesin shqiptar EITI.

¹² <https://eiti.org/board-decision/2019-44>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

	Tema	Objektivi	Aktivitete	Personat/Institucioni Përgjegjës	Afatet Kohore	Kosto	Fonde ne Dispozicion		Status
							Banka Boterore	Buxheti Shtetit	
1	Plani i punes 2020	Perpilimi i Planit te punes ne perputhje me Standartin EITI	<p>Planifikimi i aktiviteve</p> <p>Riorganizimi i aktiviteve duke perfshire dhe aktivitetet e parealizuara te planit te punes gjate vitit 2019. Miratimi nga MSG</p> <p>Prezantimi tek Grupet e Interesit</p> <p>Publikimi online ne faqen zyrtare EITI Shqiptar</p>	EITI Shqiptar MSG	Janar 2020	Nuk ka			Në vazhdim
2	Raportimi i aktiviteve vjetore 2019	Përgatitja e Raportit të progresit të ecurisë së punës gjatë vitit 2019 për EITI Shqiptar	<p>Renditja e aktiviteve te kryera nga Sekretariati Shqiptar EITI gjate vitit 2019</p> <p>Analizimi dhe evidentimi i aktiviteve te parealizuara, shkaqet e mosrealizimit.</p>	EITI Shqiptar MSG	Janar – Shkurt 2020	Nuk ka			Përfunduar
3	MSG	<p>Riorganizimi i MSG</p> <p>Grupi i Punës i Përherëshëm</p>	<p>Percaktimi i anetareve perfaqesues te Grupeve Interesit (Qeveri/ Biznes OSHC)</p> <p>Krijimi i Grupit të Punës</p> <p>Draftimi i Planit të Veprimit që do të ndiqet për veprimet korrigjuese dalë nga procesi i Validimit dhe rekomandimet e Raporteve EITI</p> <p>Ndjekja dhe adresimi i veprimeve korrigjuese dalë nga procesi i Validimit</p>	MSG MSG MSG MSG	<p>Janar - Shkurt 2020</p> <p>1 Mars 2019</p> <p>Shkurt 2020</p>	Nuk ka Nuk ka			<p>Në proces</p> <p>Përfunduar</p> <p>Në proces</p>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

			<i>dhe rekomandimet e Raporteve EITI</i>						
4	<i>Shqyrtimi Ligjor dhe Rregullator</i>	<i>Sigurimi i një legjislacioni të qëndrueshëm për zbatimin EITI në Shqipëri</i>	<i>Miratimi i ligjit të ri për Transparencë + komplementar me ligjet dhe udhëzimet e propozuar në fund të procesit të konsultimit</i>	<i>MIE; MSG EITI Shqiptar Qeveria</i>	<i>Dhjetor 2020</i>	<i>Nuk ka</i>			<i>Ka filluar procesi i aprovimit me MIE</i>
5	<i>Aktivite Komunikimi</i>	<i>Aktivitetet e Komunikimit për 2020</i>	<i>Komunikimi dhe informimi për 2020 (fushata ne media, internet dhe aktivitetet ne median sociale, evente sensibilizuese)</i>	<i>EITI Shqiptar / MSG/ Konsulenti</i>	<i>Prill 2020</i>	<i>Granti BB</i>			<i>Ka filluar</i>
6	<i>Raporti EITI 2017 dhe 2018</i>	<i>Pergatitja e TOR's</i> <i>Perzgjedhja e Administratorit te Pavarur</i>	<i>Diskutimi dhe miratimi i termave te references nga MSG referuar standarteve EITI</i> <i>Pranimi i termave te references nga Banka Boterore</i> <i>Perzgjedhja e subjekteve raportuese per raportet EITI</i> <i>Publikimi i shprehjes se Interesit per Administratorin e Pavarur</i> <i>Zhvillimi i procesit te tenderimit dhe perzgjedhja</i> <i>Nenshkrimi i kontrates me Administratorin e Pavarur</i>	<i>EITI Shqiptar / MSG</i> <i>Banka Boterore</i> <i>EITI Shqiptar</i> <i>EITI Shqiptar</i> <i>EITI Shqiptar</i> <i>EITI Shqiptar/IA</i>	<i>Gusht 2018</i> <i>Mars 2019</i> <i>Maj 2019</i> <i>Qershor 2019</i> <i>Janar 2020</i>	<i>Granti BB</i>			<i>Përfunduar</i> <i>Përfunduar</i> <i>Përfunduar</i> <i>Përfunduar</i> <i>Përfunduar</i>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

		<i>Kërkesë e Standartit EITI: Zbatimi i rekomandimeve te Raporteve të mëparshme EITI</i>	<i>Shërbime Konsulence për të ndihmuar agjencitë qeveritare me zbatimin e rekomandimeve nga raportet e EITI (kërkesë e Standartit EITI)</i>	<i>EITI Shqiptar/IA</i>	<i>Janar – Prill 2020</i>				<i>Në proces</i>
		<i>Publikimi i raporteve EITI</i>	<i>Njohja e publikut te gjere me rezultatet e raporteve EITI</i>	<i>EITI Shqiptar/IA</i>	<i>Tetor-Nëntor 2020</i>				<i>Nuk ka filluar</i>
7	<i>Validimi EITI 2020</i>	<i>Zbatimi i Veprimeve Korrigjuese të Validimit të dytë</i> <i>Ref: Standarti EITI Pjesemarrja ne procesin e tretë të Validimit</i>	<i>Adresimi i Veprimeve Korrigjuese nga Raporti i Validimit dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve</i> <i>Asistenca, venia ne dispozicion e materialeve sipas kerkesave ne procesin e validimit EITI 2020</i>	<i>EITI Nderkombetar / MSG / EITI Shqiptar</i> <i>EITI Nderkombetar/ MSG / EITI Shqiptar</i>	<i>Janar – Maj 2020</i> <i>Janar 2021</i>	<i>Nuk ka</i>			<i>Në proces</i> <i>Nuk ka filluar</i>
8	<i>Studim mbi transparencen ne perdorimin e te ardhurave nga renta dhe donacionet e kompanive te industrisë nxjerrëse ne Pushtetin vendor</i>	<i>Percaktimi i mekanizmave per perdorimin e te ardhurave nga renta ne Pushtetin vendor</i>	<i>Takime me drejtuesit dhe strukturat organizative te Bashkive dhe qeverisjes vendore, me grupet e interesit për shpërndarjen e rentës, mbështetjen nga donacionet dhe projektet e përgatitura për komunitetin.</i> <i>Publikimi i studimit dhe rekomandimet per permiresime</i>	<i>EITI Shqiptar / MSG</i>	<i>Janar – Qershor 2020</i>	<i>Nuk ka</i>			<i>Në proces</i>
9	<i>Sondazhe mbi impaktin EITI</i>	<i>Ref: Standarti EITI,</i>	<i>Shperndarja dhe plotesimi i pyetesore ne: Bulqize, Patos, Fier, Selenice, Kukes,</i>	<i>EITI Shqiptar</i>	<i>Shtator – Nentor 2020</i>	<i>Nuk ka</i>			<i>Ka filluar</i>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

		<i>Sondazh mbi impaktin e veprimtarise EITI pas publikimit te raportit EITI 2017 dhe 2018</i>	<i>Librazhd, Perrenjas, Pogradec, Tirane. Analizimi statistikor i te dhenave te marra nga pyetesoret Publikimi i analizes mbi impaktin EITI</i>						
10	<i>Zgjerimi i kapaciteteve EITI</i>	<i>Programe trajnimi për stafin e EITI Shqiptar dhe anetaret e MSG Trajnime te përshtatura për të gjitha palët e interesit në aspektet e Qeverisjes Burimeve Natyrore</i>	<i>Trajnime nga ASPA,Standartet e Komunikimit, Zhvillimi i Politikave Publike, Menaxhimi i Projekteve, Prokurime Publike, etj. Trajnim i anetareve te MSG, mbi rolin e MSG, qellimin, mundesine dhe kapacitetet qe ka per te vepruar dhe i grupeve te interesit mbi rritjen e rolit te tyre ne Industrine Nxjerrrese. Trajnim për Standartin e ri 2016+ Pronesia e Vertetë BO), dhënia e informacioneve shpjeguese Trajnimi i punonjësve të Qeverisë, stafit te EITI + përfaqësuesit MSG, në të gjitha aspektet e çështjeve të qeverisjes të Burimeve Natyrore, si Paketës Fiskale, Korniza Ligjore, Përmbajtja Lokale, Mjedisi, Taksimi, GIS dhe sistemi kadaster, arbitrazh dhe kontratat ndërkombëtare etj Përcaktimi i Kurseve të plota trajnuese ofruar nga agjenci me reputacion në këtë drejtim, siç janë Universitetet, Agjenci kërkimore etj Pjesëmarrja e palëve të interesit në Forume ndërkombëtare, Workshop-e të fokusuara në zbulimin e Perfituesve te Vertete + Qeverisjen e Burimeve Natyrore</i>	<i>EITI Shqiptar MSG EITI Shqiptar/ Konsulent EITI Shqiptar</i>	<i>2020 2020 2020 2020</i>		<i>Grant BB Grant BB</i>		<i>Ne vazhdim Ne vazhdim Ne vazhdim</i>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

		<i>Support i vazhdueshem ne Proceset EITI</i>	<i>Konsulencë për Institucionet qeveritare dhe kompanite që operojnë në industrinë nxjerrëse</i>	<i>IA + EITI Shqiptar</i>	<i>Janar – Prill 2020</i>	<i>Grant BB</i>		<i>Ne vazhdim</i>
11	Projekte shtese	<i>Studim mbi ndikimin e industrive nxjerrëse kontributin në Rritjen ekonomike, të Punësimit si dhe aspektin social në Shqipëri</i>	<i>Vendosja e objektivave, Hartimi ToR, Procesi i përzgjedhjes të Konsulentit, Raporti Final</i>	<i>EITI Shqiptar MSG / Konsulenti</i>	<i>Shtator - Nëntor 2020</i>	<i>Grant BB</i>		<i>Ka filluar</i>
		<i>Studim mbi ndikimin e industrive nxjerrëse në Mjedis</i>	<i>Vendosja e objektivave, Hartimi ToR, Procesi i përzgjedhjes të konsulentit, Raporti Final</i>	<i>EITI Shqiptar MSG / Konsulenti</i>	<i>Shtator-Tetor 2020</i>	<i>Grant BB</i>		<i>Ka filluar</i>
		<i>Sistemi i Kadastres minerare online</i>	<i>Percaktimi i objektivave Hartimi TOR per përmirësim ne sistemin kadastral për industrinë nxjerrëse minerar. Ndërtimi i Regjistrit te Licencave online</i>	<i>MIE / EITI Shqiptar/ AKBN/ Konsulenti</i>	<i>Tetor-Dhjetor2020</i>	<i>Grant BB</i>		<i>Ka filluar</i>
		<i>Qendra Informative e Industrise Nxjerrrese EITI (Aktivitet i propozuar nga Z. Ilir Aliaj)</i>	<i>Realizimi i databases se sistemit te integruar te te dhenave mbi industrine nxjerrrese</i>	<i>EITI Shqiptar MSG/ Konsulenti</i>	<i>Shtator-Dhjetor 2020</i>	<i>Grant BB</i>		<i>Ka filluar</i>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

12	<p><i>Dhënia e informacioneve mbi Pronesine e Vertete (BO)</i></p>	<p><i>Ref: Standarti EITI;</i> <i>Kuadri institucional për zbulimin e Pronësisë se Vertete</i></p>	<p><i>Shqyrtimi ligjor dhe rregullator në lidhje me zbulimin e Pronesise se Vertete në vend ne nivel të Brendshëm, publikimi i Udhëzuesit për Pronësinë e Vërtetë</i></p> <p><i>Konsultime me agjencitë qeveritare, me qëllim identifikimin e agjencisë (ive) që është përgjegjës, ose mund të jetë e përshtatshme për të mbikëqyrur, mbledhur dhe për të ruajtur informacionin mbi Pronësinë e Vertete</i></p> <p><i>Konsultimi me palët e interesit me qëllim për të përcaktuar nivelin e detajeve të dhënies së informacioneve shpjeguese të Pronësisë të Vertete (kombësisë, vendit te rezidences, nivelit të pronësisë, si pronësia është ushtruar, data e lindjes, adresa e banimit, mjeteve të kontaktit, etj), duke përfshirë mundësitë dhe sfidat me dhënien e informacioneve shpjeguese të tilla si:</i></p> <p><i>a.. Konsultime me qeverine</i></p> <p><i>b. Konsultime me shoqerine civile</i></p> <p><i>c. Konsultime me kompanite</i></p> <p><i>Dakortesimi mbi përkufizimin e përshtatshem dhe pragjet e pronësisë dhe zbulimi në mënyrë për të operacionalizuar raportimin e Pronësisë të Vertete</i></p>	<p><i>EITI Shqiptar / Konsulenti</i></p> <p><i>MEF, MD, MIE, Komisionet Parlamentare / Konsulent</i></p>	<p><i>Mars – Dhjetor 2020</i></p>				<p><i>Ligji, Për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues u Miratua nga Kuvendi i Shqipërisë Nr.112/2020</i></p>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

			<p><i>Zbatimi i ndryshimeve Ligjore dhe rregullative</i></p> <p><i>Ngritja e kapaciteteve për MSG/ Ndërtimi i Kapaciteteve për entitetet qeveritare / Nndërtimin e kapaciteteve për kompanite, aktivitete shkëmbimi me vendet e tjera per Pronesine e Vertete</i></p> <p><i>Shqyrtimi i kohës më të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave të informacionit të pronësisë se vertete</i></p> <p><i>Identifikimi i një mekanizmi të përshtatshëm për kompanitë për të siguruar të dhënat në deklaratat për pronësinë e vertete para mbledhjes së të dhënave</i></p> <p><i>Identifikimi i kompanive që do të jetë e nevojshme të marrin pjesë në raportimin per pronësinë e vertete</i></p> <p><i>Identifikimi i qasjes më efektive dhe të qëndrueshme te mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë për shembull realizimin e një forme të deklaramit të pronësisë së vertete, ose përshtatje e modelit të EITI</i></p> <p><i>Rritja e aksesit ndaj të dhënave, për shembull, me publikimin e të dhënave në formate elektronike apo të dhëna të tjera të hapura</i></p> <p><i>Konsiderimi i krijimit të regjistrit publik të pronësisë së vertete, të integruar në mënyrë ideale në regjistrat ekzistuese të korporatave, ose mbajtjesve te licencesave</i></p>						
--	--	--	---	--	--	--	--	--	--

EITI Shqiptar Plani i Punes 2020 (ver. 1.1)

			<i>nxjerrese</i>							
13	<i>Të Dhëna të hapura</i>	<i>Ref: Standarti EITI,</i>	<i>Përfshirja e të Dhënave të hapura për EITI dhe qeverisjen e Burimeve Natyrore, në prioritetet kombëtare për sistemet e hapura të të dhënave të Qeverisë dhe të punuarit drejt integritit, krijimin e të dhënave të hapura për EITI në sistemet qeveritare për të siguruar afate kohore, cilësi të të dhënave, ripërdorim dhe efektivitet në kosto</i>	<i>EITI Shqiptar / MIE/ Konsulenti</i>	<i>Maj – Dhjetor 2020</i>	<i>Granti BB</i>			<i>Ka filluar</i>	
<i>Totali i pritur për Aktivitetet e financuara nga BB (pa shpenzime operative)</i>								<i>\$542'200</i>		
<i>Totali i Pritur per aktivitetet e propozuara</i>								<i>\$734'600</i>		
<i>Burime financimi të paidentifikuara / potenciale</i>								<i>\$192'400</i>		